REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ✓

Nr. 4257 Prot. Tiranë, më 11.11.2024

Lënda: **Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektvendim.**

Drejtuar: **Znj. Elisa SPIROPALI**
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Këtu

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 75, pika 2 të Kushtetutës dhe nenit 117 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektvendim "*Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, "Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar*", të propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektvendimi në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

KRYETARI

Gazment BARDHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTVENDIM

Nr. _____/2024

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 75, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 117 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, me propozimin e deputetit Gazment Bardhi,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, "Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Neni 1

Pas nenit 62/1, shtohet neni 62/2, me përmbajtje si më poshtë:
1. Çdo deputet i Kuvendit të Shqipërisë duhet të plotësojë formularin e vetëdeklarimit "Mbi përdorimin e aplikacioneve SKY ECC dhe ENCROCHAT", sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Formulari i vetëdeklarimit plotësohet nga deputeti personalisht. Deklarimi i të dhënave të rreme ose të shtrembëruara përbën vepër penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal.
3. Plotësimi i formularit të vetëdeklarimit duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe dorëzohet pranë Shërbimit të Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve.
4. Formularët e vetëdeklarimit dhe të dhënat e përfshira në to publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë dhe një kopje e tyre i përcillet për dijeni Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R J A

Elisa SPIROPALI

Miratuar, më ____.____.2024

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Nga hetimet e kryera nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në bashkëpunim me agjencitë ligjzbatuese evropiane, veçanërisht të Francës, Belgjikës dhe Hollandës, ka rezultuar se gjuha shqipe është gjuha e dytë më e përdorur në aplikacionet e enkriptuara SKY ECC dhe ENCROCHAT, me rreth 16 mijë përdorues shqiptar. Hetimet kanë zbuluar se përdorues të këtyre aplikacioneve nuk kanë qenë vetëm anëtarë të grupeve kriminale, me shtrirje ndërkombëtare, por edhe funksionarë të lartë publik shqiptar, duke përfshirë funksionarë të Policisë, organeve të drejtësisë, pushtetit vendor dhe qëndror.

Hetimet e kryera në kuadër të disa procedimeve penal, kanë zbardhur komunikimet e të deputetëve të Partisë Socialiste me grupe dhe eksponentë të krimit të organizuar. Nga të dhënat e përftuara nga këto komunikime ka rezultuar se eksponentë të krimit të organizuar kanë ndërhyrë madje edhe në strukturat drejtuese të Partisë Socialiste për të përcaktuar pozicionin e këtij deputeti në listën e kandidatëve të Partisë Socialiste dhe për të siguruar vota për partinë Socialiste, me qëllim zgjedhjen e tij. Deputetët nga ana tjetër kanë ndihmuar në organet e drejtësisë me qëllim favorizimin dhe moskapjen e eksponentëve të krimit të organizuar.

Gjithashtu, nga burime të ndryshme mediatike janë hedhur dyshime serioze se në aktet e dërguara nga autoritetet franceze, belge dhe hollandeze të drejtësisë, rezultojnë komunikime edhe të deputetëve të tjerë me eksponentë të krimit të organizuar, për kryerjen e aktiviteteve të paligjshme. Këto dyshime ngrejnë pikëpyetje mbi integritetin, etikën dhe besueshmërinë jo vetëm të deputetëve, por edhe të vetë institucionit të Kuvendit të Shqipërisë, i cili ka për funksion themelor të sigurojë përfaqësimin dinjitoz të qytetarëve dhe një proces ligjbërës të udhëhequr nga interesi publik.

Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, si përfaqësues të qytetarëve, duhet të mishërojnë standardet më të larta të integritetit profesional dhe moral, etikës dhe ligjshmërisë. Ekzistenca e komunikimeve në aplikacionet e enkriptuara, që dihet botërisht se

përdoreshin nga grupet kriminale, me qëllim ushtrimin e aktiviteteve të paligjshme, dëmton rëndë reputacionin dhe kredibilitetin e deputetëve dhe Kuvendit të Shqipërisë. Prandaj, nisur edhe nga modeli i përdorur për punonjësit e Policisë së Shtetit, të miratuar me urdhërin nr. 196, datë 04.12.2023 të Ministrit të Brendshëm, me qëllim ruajtjen e standardeve më të larta etike dhe të integritetit, është propozuar detyrimi i çdo deputeti të Kuvendit të Shqipërisë, për të plotësuar formularin e vetëdeklarimit "Mbi përdorimin e aplikacioneve SKY ECC dhe ENCROCHAT".

Neni 62/2, i propozuar për t'u shtuar në Rregulloren e Kuvendit, parashikon, krahas detyrimit për plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, modelin e vetëdeklarimit, afatin e dorëzimit të këtij formulari, strukturën administruese, pasojat e plotësimit me të dhëna të rreme, publikimin në faqen zyrtare të Kuvendit, në përputhje me parimin e transparencës, dhe përcjelljen për dijeni Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Si shprehje e vullnetit të plotë për miratimin e kësaj dispozite, deputeti propozues i këtij projektvendimi, do të dorëzojë bashkëlidhur edhe formularin e vetëdeklarimit "Mbi përdorimin e aplikacioneve SKY ECC dhe ENCROCHAT", të plotësuar.

D E P U T E T I

Gazment BARDHI



FORMULAR VETËDEKLARIMI

MBI PËRDORIMIN E APLIKACIONEVE SKY ECC DHE ENCROCHAT

DATË ____.____._____

I. TË DHËNAT PERSONALE

EMËR	
MBIEMËR	
ATËSI	
AMËSI	
DATËLINDJE	
VENDLINDJE	
VENDBANIM	
NR. ID	

II. MARRJE DIJENI MBI EFEKTET E FORMULARIT

Unë, i nënshkruari _____, kam marrë dijeni dhe jam i vetëdijshëm se:

a) Ky formular përbën dokument zyrtar i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet publikimit.

b) Një kopje e këtij formulari i përcillet për dijeni Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

c) Pasqyrimi i të dhënave të rreme apo të shtrembëruara përbën vepër penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal.

III. TË DHËNA MBI PËRDORIMIN E APLIKACIONEVE SKY ECC DHE ENCROCHAT

1. A keni qenë përdorues i aplikacionit ENCROCHAT?

PO _____ JO _____

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

- Periudha e përdorimit: _____
- Arsyeja e përdorimit: _____

2. A keni qenë përdorues i aplikacionit SKY ECC?

PO _____ JO _____

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

- Periudha e përdorimit: _____
- Arsyeja e përdorimit: _____

3. A keni pasur zotërim të një telefoni të enkriptuar në aplikacionin ENCROCHAT dhe SKY ECC?

PO _____ JO _____

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

- Periudha e përdorimit: _____
- Arsyeja e përdorimit: _____

* * *

Duke qenë i vetdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

_____

(emër, mbiemër, firmë)